



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - HANI I ELEZIT
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE



07/Nr. 3814 /2019
Data: 30.04.2019

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të punës dhe kërkesës së QKMF-së „Dr.Menduh Kaloshi” në Hani i Elezit, Drejtoria e DSHMS-së shpall këtë:

K O N K U R S

-Titulli i postit: **(1)Një Mjekë-e të Mjekësisë Familjare** për kohë të pacaktuar
1(Një) në **Hani të Elezit**

-Paga: Koeficienti H 27/Gr.St/ H - 565 / 1

-Kualifikimi: Fakulteti i Mjekësisë

▪ Detyrat kryesore:

-Ndihmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçantë në lëmin të cilën është trajnuar.

-Mban evidencën e rregullt të dokumentacionit mjekësorë, kartelën e pacientit si dhe dokumente të tjera.

-Jep udhëzime me gojë dhe me shkrim për trajtime të pacientit .

-Merr pjesë në hartimin e planit dhe programit në vendin e punës ku punon.

-Mban kujdestarinë e radhës dhe kryen punë tjera sipas kërkesës së eprorit.

-Kujdeset për shëndetin e pacientëve, përshkruan dhe administron tretmanët, medikamentet dhe i aplikon masat tjera shëruese.

-Ndihmon në preventivin e sëmundjeve dhe çrregullimeve duke këshilluar pacientët në lidhje me dietën ushtrimet, higjienën dhe shëndetin në përgjithësi.

-Të raporton për lindjet, vdekjet, sëmundjet ngjitëse autoriteteve kompetente.

-Të i referon pacientët tek specialistët mjekësorë dhe të shkëmben me ta të dhënat mjekësore.

-Të përpilon raporte me shkrim lidhur me punën dhe veprimet e tije.

-Përvoja profesionale: E dëshirueshme

▪ Të drejtë pjesëmarrje në konkurs kanë të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës (letërnjoftimi) fotokopje.

2. Të kenë të kryer Fakultetin e Mjekësisë (Diploma) e vërtetuar në Komunë ose te Noteri.

3. Të kenë të kryer Praktikën profesionale dhe të vërtetuar (Licenca) e vërtetuar në komunë ose Noteri.

4. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (Tatimi në pronë).

5. Certifikata e mjekut.

6. Vërtetim nga gjykata që nuk ndjekej penalisht.

7. Kualifikime tjera (Trajnime).

-Periudha e kontratës: Për gjashtë muaj punë provuese me mundësi të vazhdimit të kontratës në bazë të suksesit dhe rezultateve në punë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, duke llogaritur prej ditës së publikimit në mjetet e informimit publik. Formularët për aplikim mundë të merren dhe dorëzohen të plotësuar në zyrën për shërbim të qytetarëve në shërbimin e shkrimores komuna Hani i Elezit . Formularët e konkurrit duhet të dorëzohen së bashku me dëshmitë për kualifikimin shkollor, kurset e ndjekura dhe dy referenca. Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes tabelës së shpalljeve. Komuna e Hanit të Elezit i shërben të gjithë popullit të Kosovës dhe mirëpret aplikacionet për meshkuj dhe femrat prej të gjitha komuniteteve kosovare.

Hani i Elezit
30.04.2019

